

Tagesschulen Thun

Fletëudhëzim për prindërit

Vlen rregullorja për shkollën ditore („Verordnung über die Tagesschulen- VTS“) e qytetit të Thun-it (www.thun.ch/tagesschulverordnung).

- Oferta** Shkolla ditore (Tagesschule) ofron nxitje kuptimplote për kalimin e kohës së lirë si dhe përkujdesje (mbikqyrje) gjat kryerjes së detyrave. Në Tagesschule nuk ofrohet mësimi plotësues. Përkujdesja në mesditë përfshin drekën (ushqimin) e të gjithë fëmijëve së bashku, si dhe kohën për pushim dhe qetësim.
- Rruga** Nëse Tagesschule nuk gjindet afër ndërtesës shkollore apo kopshtit të fëmijëve (Kindergarten), atëherë për fëmijët deri në klasën e 3-të, bëhet përcjellja (përkujdesja) gjat rrugës ndërmjet shkollës / kopshtit për fëmij (Kindergarten) dhe shkollës ditore (Tagesschule). Në marëveshje të veçantë si dhe me një leje me shkrim, ka mundësi që kjo të rregullohet ndryshe. Fëmijët më të vjetër (mbi klasën e 4) e bëjnë rrugën vetë (në përgjegjësi të vetën).
- Regjistrimi** Regjistrimi vlenë për tërë vitin shkollorë si dhe për njësitë e porositura të përkujdesjes. Rastet e veçanta duhet të arsyetohen. Ndryshimet janë të mundëshme vetëm në fund të një semestri shkollorë.
- Çlajmërimi** Fëmijët mund të çlajmërohen nga Tagesschule në fund të një semestri shkollorë, pasi të paraqitet arsyetimi (shkaku). Kërkesa për çlajmërim bëhet me shkrim dhe i parashtrohet drejtoratit të shkollës ditore (Tagesschulleitung), 30 ditë para përfundimit të semestrit shkollorë.
- Pagesa** Pagesa (çmimi) rregullohet sipas paracaktimit kantonal. Kjo bëhet me fatura (Rechnung) çdo 3 muaj.
- Lirimi nga pagesa** Çlajmërimet afatshkurte (aty për aty) nuk mundësojnë lirim nga pagesa. Çlajmërimet me kohë për ushqim të mesditës (një ditë më parë gjer në orën 18.00 tek drejtuesi i shkollës ditore), janë të arsyetuara dhe nuk paguhen. Mungesat në kohëzgjatje më të madhe, nëse bëhen me arsyetim të bindshëm, mundëson një redukim (zvogëlim) të përshtatshëm të pagesës. Nëse mungesat bëhen për shkaqe shkollore (p.sh. Landschulwoche, Skilager, ekskursionet shkollore disa ditore), atëherë pason një shkurtim i pjesërishtëm i pagesës. Këto mungesa duhet të lajmërohen me shkrim drejtuesit të shkollës ditore (Tagesschulleitung) 14 ditë para këtyre ngjarjeve.
- Sigurimi** Sigurimi për fatkeqësi (Unfallversicherung) është qështje e vetë prindërve.
- Informatat** Për informata të tjera drejtohuni udhëheqësisë së shkollës ditore -Tagesschulleitung.